

# Asylum Support Partnership

## help and advice



March 2009

Albanian

## Aplikimi për përkrahje sociale dhe financiare gjatë procesit të azilit.

Zakonisht, pjesa më e madhe e azil kërkuarve nuk lejohet që të punojnë. Vetëm në raste tepër të veçanta juve mund t'ju jepet e drejta të punoni, por gjithësesi bëni mirë të kërkonti këshillim lidhur me këtë.

Duke qenë se procesi i azilit mund të jetë i gjatë, ju duhet të mendoni sesi do të përballoni financiarisht jetesën tuaj. Ju mund të keni të drejtë për të aplikuar për përkrahje sociale dhe financiare tek Agjencia Britanike e Kufinjve (UK Border Agency - UKBA). UKBA është departamenti qeveritar përgjegjës për të përkrahur azil kërkuar në nevojë. UKBA mund t'ju sigurojë si akomodim ashtu edhe përkrahje financiare për ushqim dhe veshmbadhje. Nëse keni një vend për tu akomoduar, psh me miq ose fisin tuaj, mund të aplikoni vetëm për përkrahje financiare. Përkrahja financiare quhet gjithashtu "përkrahje për mbijetesë".

Nëse nuk keni mundësi ta përballoni vetë jetesën tuaj, ju mund të aplikoni për përkrahje azili gjatë kohës së procesit të azilit. Nëse pranoheni nga UKBA dhe / ose shërbimi shoqëror, jeni nën 18 vjeç, dhe po aplikoni për azil vetëm, ju do të merrni përkrahje nga autoritetet vendore. Në të njëjtën kohë që jeni duke aplikuar për azil ju mund të kërkonti përkrahje dhe UKBA duhet t'ju sigurojë një akomodim të përkohshëm ndërsa jeni duke përfunduar aplikimin.

### Kush ka të drejtë ndaj përkrahjes së dhënë nga UKBA?

Juve mund t'ju nevojitet si ndihmë financiare ashtu dhe akomodim, ose ndoshta vetëm përkrahje financiare. Në të gjitha rastet, është e nevojshme që ju të verifikoni disa gjëra tek UKBA:

- Që ju keni aplikuar për azil dhe aplikimi juaj nuk është refuzuar.
- Që ju jeni i pastrehë dhe i varfër (që do të thotë ju keni shumë pak ose nuk keni para, as banesë)
- Që ju keni aplikuar për azil "në momentin më të parë të mundshëm" pasi keni mbërritur në Britani.
- Që ju jeni mbi 18 vjeç.

### Çfarë do të thotë "në momentin më të parë të mundshëm"?

Ky test vlen për ata njerëz të cilët po aplikojnë si për akomodim ashtu dhe për përkrahje financiare. Kur ju aplikoni vetë për mbështetje financiare (edhe atëherë kur më parë ju keni marrë përkrahje financiare dhe akomodim dhe kërkonti tani vetëm mbështetje financiare) UKBA do të marrë parasysh gjërat si vijojnë:

Fletëpalosje të tjera janë të disponueshme tek <http://languages.refugeecouncil.org.uk>

Asylum Support Partnership is a partnership project hosted by the British Refugee Council  
British Refugee Council, (commonly called the Refugee Council) is a company limited by guarantee registered in England and Wales, [No 2727514] and a registered charity, [No 1014576].  
Registered office: 240-250 Ferndale Road, London SW9 8BB, United Kingdom, VAT reg no: 936 519 988



- Nëse keni aplikuar për azil brenda tre ditësh që nga momenti i mbërritjes;
- Nëse rrëfimi i dhënë prej jush lidhur me mbërritjen në Britani është i besueshëm.

Zakonisht UKBA do të përdorë informacionin që i keni dhënë lidhur me aplikimin tuaj për azil për të përcaktuar nëse me të vërtetë keni aplikuar në “momentin më të parë të mundshëm”. Nëse UKBA nuk është në gjendje të marrë një vendim për t’ju dhënë apo jo përkrahje, ose nëse mendojnë që ju nuk keni aplikuar për azil aq shpejt sa duhet, atëherë ata do t’ju ftojnë për një intervistë në Croydon, Glasgow ose Liverpool. Nëse ju informoni UKBA që nuk keni mundësi financiare për të përballuar udhëtimin në Croydon, atëherë intervista mund të zhvillohet në një nga zyrat rajonale pranë vendin ku ju jetoni. **Është thelbësore që ju të merrni pjesë në këtë intervistë nëse doni të vërtetoni që keni nevojë për përkrahje dhe që keni aplikuar për azil në “momentin më të parë të mundshëm”**.

UKBA nuk do ta refuzojë kërkesën tuaj për përkrahje nëse aplikohen kushtet e mëposhtme :

- Jeni pjesë e një familje me fëmijë nën 18 vjeç;
- Keni nevojë të veçanta, psh handikape mendore apo fizike; nëse keni nevojë të veçanta juve ju jepet e drejta të vërtetoni nevojat tuaja pranë autoriteteve vendore nën legjislacionin komunitar të kujdesit. Disa azil kërkuarve me nevojë të veçanta do t’ju sigurohet akomodim dhe përkrahje e mëtejshme nga UKBA;
- Kur ju arrini të vërtetoni që ju do të vuani një trajtim ç’njerëzor dhe degradues, siç është parashikuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nëse Qeveria nuk ju jep të drejtën e përkrahjes. Është e nevojshme të kërkonti këshillim ligjor për të parë nëse ky rast është i aplikueshëm për ju.

Nëse ju ndodheni tashmë në Britani në mënyrë ligjore, dhe keni aplikuar më pas për azil si rezultat i ndryshimeve politike në vendin tuaj, UKBA do të marrë në shqyrtim nëse ju keni aplikuar në rastin më të parë.

## Si mund të aplikojë për përkrahjen e UKBA?

Organizatave për refugjatët të listuara në fund të kësaj fletëpalosje do ju ndihmojnë për të aplikuar për përkrahje pranë UKBA. Gjithashtu, organizata të tjera të tilla si zyra lokale e shërbimit Këshillimi Qytetar (Citizens Advice) apo grupet për refugjatët mund t’ju ndihmojnë për të aplikuar. Nëse jeni ndaluar dhe po mbaheni në një qëndër shpërnguljeje dhe jeni i sukseshëm gjatë aplikimit të garancisë për të dalë nga kjo qëndër, një nga organizatat për refugjatët mund t’ju ndihmojë për të aplikuar për përkrahje pranë UKBA.

## Kam nevojë për akomodim dhe përkrahje financiare

Ju mund të aplikoni në të njëjtën kohë për akomodim dhe mbështetje financiare. Nëse nuk keni ku të jetoni ndërsa po prisni për një vendim të UKBA për t’ju dhënë përkrahje, atëherë UKBA do t’ju vendosë në një qëndër prezantimi, ose në një akomodim të përkohshëm. Nëse keni kërkuar tashmë azil dhe mbeteni pa të ardhura dhe banesë, një organizatë për refugjatët mund t’ju drejtojë tek UKBA për një akomodim fillestar. Akomodimi fillestar do të thotë një vend ku azil kërkuarët akomodohen dhe u jepet ushqim dhe përkrahje financiare për një periudhë të shkurtër kohore.

## UKBA bie dakort që të më akomodojë

Nëse UKBA vendos që ju keni të drejtë për përkrahje, atëherë ata do të organizojnë akomodimin tuaj, zakonisht jashtë Londrës dhe Anglisë Juglindore (quajtur gjithashtu shpërhapje). Kjo formë akomodimi do të jetë normalisht pranë banesës gjatë akomodimit fillestar. Ju s’mund të zgjidhni se ku do t’ju vendosë UKBA; por ata do të marrin parasysh nevojat e tua fizike si dhe kushtet tuaja personale. Para se të lëvizni në banesën e siguruar

nga UKBA , ju do të informoheni rreth vendit ku do jetoni, si mund të udhëtoni për atje, si mund të merrni përkrahje financiare, dhe cilin duhet të kontaktoni në vendndodhjen e re nëse hasni probleme.

### **Çfarë lloj akomodimi do të marrë?**

UKBA zakonisht do t'ju vendosë në shtëpi ose apartamente të përbashkëta. Njerëzit që manaxhojnë këto vende quhen zot shtëpie. Ata do ju sigurojnë fjetjen, pajisje bazike të kuzhinës dhe do të jenë përgjegjës për t'ju ndihmuar që të kontaktoni dhe të përdorni shërbimet e zonës ku ndodheni. Ata do bëjnë të mundur që ju të kontaktoni doktorin, shkollën apo kolegjin e zonës. I zoti i shtëpisë është përgjegjës për t'ju siguruar që banesa juaj është në kushte normale. Nëse keni ndonjë shqetësim lidhur me akomodimin tuaj ose lidhur me kontaktimin e shërbimeve të zonës, flisni për këto me të zotin e shtëpisë ose me Shërbimin për Këshillim dhe Ndhimë (One Stop Service). Ju lutem kini parasysh se mund t'ju kërkohet të ndani apartamentin me dikë tjetër që nuk e njihni.

### **Për sa kohë mund të qëndrojnë në banesën e dhënë nga UKBA ?**

UKBA kërkon prej jush të qëndroni në banesën që ata ju kanë siguruar, përveç rasteve kur ju jep leje për të lëvizur. Nëse largoheni nga banesa pa lejen, UKBA ka të drejtën të ndalojë përkrahjen e dhënë për juve. Nëse dëshironi të largoheni nga banesa e dhënë nga UKBA dhe të qëndroni me dikë tjetër, atëherë ju duhet të informoni UKBA për këto ndryshime. Ju mund të qëndroni në banesën e dhënë nga UKBA derisa ky institucion të marrë një vendim lidhur me aplikimin tuaj për azil. Nëse UKBA ju jep të drejtën e statusit të refugjatit, mbrojtjes humanitare, ose leje qëndrim të përkohshëm, përkrahja juaj do të përfundojë pas 28 ditësh. Kjo do të thotë që juve duhet të lini banesën brenda 28 ditësh.

### **A do të përkrahë UKBA nëse bëj një apelim?**

Nëse UKBA refuzon aplikimin tuaj për azil por keni apeluar mbrenda kufijve kohor të përcaktuar prej tyre ju mund të vazhdoni të qëndroni në akomodimin e dhënë dhe të merrni përkrahje si më pare. Nëse ndodheni në fund të procesit të azilit dhe nuk keni më të drejtë për të apeluar, UKBA do të ndalë përkrahjen tuaj 21 ditë pasi është marrë vendimi final refuzues ndaj kërkesës suaj për azil. Megjithatë ju mund të aplikoni për Seksionin 4 për përkrahjeje (Section 4 support) – njohur gjithashtu si ndihma për 'raste të veçanta' . Ju lutem lexoni fletëpalsjen e Partneritetit të Përkrahjes për Azil (Asylum Support Partnership) 'Jeni i varfër dhe në fund të procesit për azil?' tek <http://languages.refugeecouncil.org.uk> ose lexoni fletëpalosjen e Këshillit Skocez për Refugjatët 'Seksioni 4 për përkrahje', nëse jetoni në Skoci. Këshilluesi juaj ligjor apo organizata më e afërt për refugjatët mund t'ju ndihmojë për të aplikuar. Nëse keni fëmijë nën moshën 18, përkrahja juaj duhet të vazhdojë edhe nëse kërkesa juaj për azil është refuzuar.

## **Kam nevojë vetëm për përkrahje financiare**

Nëse keni një vend ku mund të qëndroni, psh me miq apo fisin, ju mund të aplikoni tek UKBA vetëm për mbështetje financiare. Duhet disa javë që UKBA të marrë në shqyrtim aplikimin tuaj. Asnjë përkrahje s'do mund t'ju jepet gjatë kësaj periudhe, dhe përkrahje do të jepet vetëm pas datës që UKBA merr vendimin lidhur me aplikimin tuaj, dhe jo nga data kur ju dorëzoni këtë aplikim. Nëse UKBA bie dakort për t'ju dhënë përkrahje financiare, atëherë këto janë hapat që do të ndiqen:

1. UKBA do t'ju dërgojë një letër ku konfirmon që ju keni të drejtë për të marrë përkrahje financiare.
2. Ata do t'ju japin kupon të quajtura tollona të përkoshme. Ato janë të vlefshme vetëm për një periudhë të shkurtë kohore. Ju mund t'i shkëmbeni këto me para pranë zyrave të postës.
3. Nëse keni Kartën e Aplikimit të Regjistrimit (Application Registration Card - ARC) atëherë do të keni mundësin për të tërhequr pagesat e vazhdueshme duke paraqitur kartën tuaj

pranë zyrës postare. Sodexho, kompania që jep këto pagesa, do t'ju dërgojë një letër ku konfirmon se në cilën zyrë postare duhet të tërhiqni paratë.

Nëse keni pyetje lidhur me përkrahjen tuaj financiare ose po hasni problem telefononi linjën telefonike për ndihmë të UKBA tek **0845 602 1739** ose vizitoni qendrën më të afërt të Shërbimit për Këshillim dhe Ndihmë. Ju lutem keni parasysh që kjo linjë është e vlefshme gjithashtu dhe për ata të cilët kanë aplikuar si për përkrahje financiare ashtu dhe për akomodim.

### **Çfarë ndodh nëse humbas tollonat ose ARC?**

Nëse keni humbur tollonin tuaj ose ARC, apo dikush e ka vjedhur atë, ju duhet të raportoni humbjen ose vjedhjen e kryer pranë policisë për të marrë tollon ose ARC të re. Ju duhet të merrni një vërtetim të shkruar të raportit policor shoqëruar me numrin e protokollit për krimin e kryer, emrin e oficerit të policisë dhe të rajonit policor. Më pas këtë raport duhet ta dërgoni me fax tek UKBA në numrin **020 8633 0653** ose kontaktoni qendrën e Shërbimit për Këshillim dhe Ndihmë pranë zonës tuaj.

Nëse dëshironi të ndryshoni zyrën postare në të cilën po tërhiqni pagesën tuaj ose nëse keni vështirësi për ta tërhequr atë nëpërmjet ARC, ju duhet të të merrni në telefon Sodexhon në linjën telefonike të ndihmës **01276 687 099**. Nëse nuk flisni anglisht, duhet të merrni një përkthyes apo një shokë që t'ju ndihmojë të kryeni telefonatën.

### **Rrethanat e mia kanë ndryshuar**

Nëse keni marrë përkrahje financiare dhe rrethanat tuaja kanë ndryshuar, dhe keni nevojë dhe për akomodim, ju mund të aplikoni për akomodim në një fazë të mëtejshme. Ju duhet të kontaktoni organizatën më të afërt për refugjatë që mund t'ju ndihmojë me këtë.

## **Çfarë lloj tjetër ndihme mund të më japë UKBA?**

### **Pagesa Amësie**

Ju mund të aplikoni pranë UKBA për një ndihmë financiare amësie për fëmijë të porsalindur. Kjo është një pagëse e bërë njeherëshe prej £300 në tallona. Aplikimet duhet të kryhen me shkrim deri një muaj para ditës së parashikuar për lindje, ose jo më shumë se dy javë pasi foshnja ka lindur. Ju duhet të përfshini dokumenta për datën e parashikuar të lindjes, ose certifikatën e lindjes së fëmijës. Fëmijët që kanë lindur tre muaj para mbërritjes në Britani ose më pak, kanë të drejtën e pagesave të amësisë. Ju lutem vini re se ata që marrin përkrahje të seksionit 4 mund të marrin vetëm £250 në tallona.

### **Pagesa për gra shtatëzëna dhe për fëmijët**

Gratë shtatëzëna dhe familje me fëmijë të moshave një deri në tre vjeç, të cilët po marrin përkrahje nga UKBA, kanë të drejtën për të tërhequr një shumë shtesë prej £3 mbi pagesat bazë të UKBA. Një shumë shtesë prej £5 në javë është vënë në dispozicion të foshnjeve nën moshën një vjeççare. Këto pagesa janë të vlefshme dhe për ata që marrin përkrahje të Seksionit 4.

### **Udhëtimi për në intervistat e azilit dhe të apelit**

Nëse merrni përkrahje, UKBA do të paguajë shpenzimet e udhëtimit për intervistat lidhur me azilin ose apelin. Ju mund të aplikoni për asistencë për të paguar udhëtimin tuaj. Qendra lokale e Shërbime për Këshillim dhe Ndihmë mund t'ju ndihmojë për këtë kërkesë.

## Informacione të tjera

### Ç'ndodh nëse UKBA refuzon të më përkrahë?

Nëse UKBA refuzon t'ju përkrahë, ju keni të drejtë të apeloni tek një gjyqtar i çështjeve të përkrahjes. Në këtë kohë nuk do të mund të merrni asnjë lloj përkrahje nga UKBA ndërsa prisni që të merret vendimi i apelit.

### A mund të udhëtojë?

Ju jeni i lirë të udhëtoni brenda Britanisë së Madhe (UK), por nëse po qëndroni në një banesë të siguruar nga UKBA ju lejohet vetëm deri në shtatë ditë dhe natë largimi, ose 14 ditë dhe netë në një periudhë gjashtë mujore. Nëse keni ndërmend të largoheni nga banesa duhet të lajmëroni të zotin e shtëpisë. Nëse udhëtoni jashtë Britanisë, UKBA do ta refuzojë kërkesën tuaj për azil.

### A mund të punojë ndërsa pres për një vendim lidhur me kërkesën time për azil?

Duke qënë azil kërkues zakonisht nuk ju lejohet të punoni. Megjithatë, nëse keni më shumë se një vit që po prisni për një përgjigje fillestare lidhur me aplikimin tuaj për azil, ju mund të aplikoni për leje pune. Përfaqësuesi juaj ligjor mund t'ju ndihmojë në këtë çështje. Të gjithë mund të punojnë vullnetarisht, mënyrë nga ku mund të përftohen më së miri aftësi të reja. Një punë e tillë duhet të jetë plotësisht vullnetare dhe pa pagesë. Shpenzimet e udhëtimit dhe të drekës zakonisht ju paguhen nëse kryeni punë vullnetare.

### Shënim i Rëndësishëm:

Nëse rrethanat tuaja ndryshojnë, psh një anëtarë tjetër i familjes është bashkuar me ju, ose keni ndryshuar adresë, apo dëshironi të aplikoni për pagesë amësie, atëherë duhet ta informoni UKBA përpara se këto gjëra të ndodhin. Ju duhet të siguroheni që të tilla gjëra të shtohen tek kërkesa juaj për aplikim ose të vendosen më vete, përndryshe nuk do kene të drejtë mbështetjeje. Ju duhet t'i shkruani UKBA dhe ta informoni që rrethanat tuaja kanë ndryshuar. Ju lutem të mbani një kopje të letrës suaj. Organizata më e afërt për refugjatë e listuar si mëposhtë duhet t'ju ndihmojë.

### Përkrahje kur keni ezauruar të drejtat për apelim azili

Nëse aplikimi juaj për azil është përcaktuar në formë përfundimtare, duke përfshirë këtu dhe apelin dhe UKBA ju ka informuar që ju i keni ezauruar të gjitha të drejtat tuaja për apelim, atëherë ju mund të keni të drejtë ndaj një forme tjetër përkrahjeje të UKBA, e quajtur Seksioni 4 (Section 4). Për më tepër informacion për të ditur se si ta kërkonti këtë përkrahje ju lutem lexoni fletëpalsjen e Partneritetit të Përkrahjes për Azil (Asylum Support Partnership) 'Jeni i varfër dhe në fund të procesit për azil? tek <http://languages.refugeecouncil.org.uk> ose tek Qendra lokale e Shërbime për Këshillim dhe Ndhimë.

### Burime ndihme dhe këshillimi

Agjencitë për refugjatë të tilla si Qendra e Burimeve Multi-Kulturore (Multi-Cultural Resource Centre), Shërbimi për Refugjatë i Anglisë Veriore (North of England Refugee Service), Aksioni për Refugjatë (Refugee Action), Këshilli Refugjatëve (Refugee Council), Këshilli Skoces i Refugjatëve (Scottish Refugee Council) dhe Këshilli për Refugjatë në Uells (Welsh Refugee Council) janë organizatat kryesore që sigurojnë ndihmë dhe këshillime për azil kërkuesit. Ata besojnë se azil kërkuesit dhe refugjatët duhet të trajtohen me mirëkuptim dhe respekt. Këto organizata sigurojnë këshillime dhe informacione lidhur me akomodimin, përkrahjen financiare, azilin, shëndetin dhe çështje të tjera, nëpërmjet qendrave të Shërbimit të Këshillimit dhe të Ndhimës në rajone të ndryshme të Britanisë. Ata janë të pavarur dhe të ndarë nga shteti. Stafit i këtyre organizatave do ju japë këshillat më të mira për rastin tuaj. Por ju lutem kini parasysh që ata nuk janë në gjëndje të ndryshojnë vendimet e marra për çështjen tuaj

nga departamentet qeveritare. Organizata të tjera të tilla si shërbimi i Keshillimit Qytetar, këshillime lokale ose grupe refugjatësh mund t'ju afrojnë gjithashtu këshillime dhe informacione falas.

**Multi-Cultural Resource Centre (Northern Ireland)**

Tel: 02890 238 645

[www.mcrc-ni.org](http://www.mcrc-ni.org)

**North of England Refugee Service Head Office (North East)**

Tel: 0191 245 7311

[www.refugee.org.uk](http://www.refugee.org.uk)

**Refugee Action Head Office (East Midland, North West, South Central, South West)**

Tel: 020 7654 7700

[www.refugee-action.org.uk](http://www.refugee-action.org.uk)

**Refugee Council Head Office (London, East of England, Yorkshire & Humberside, West Midlands)**

Tel: 020 7346 6700

[www.refugeecouncil.org.uk](http://www.refugeecouncil.org.uk)

<http://languages.refugeecouncil.org.uk>

**Scottish Refugee Council**

Tel: 0141 248 9799

Freephone: 0800 085 6087

[www.scottishrefugeecouncil.org.uk](http://www.scottishrefugeecouncil.org.uk)

**Welsh Refugee Council**

Tel: 019 2048 9800

[www.welshrefugeecouncil.org](http://www.welshrefugeecouncil.org)

Asylum Support Partnership consists of:

North of England Refugee Service, charity number: 1091200 [www.refugee.org.uk](http://www.refugee.org.uk)

Refugee Action, charity number: 283660 [www.refugee-action.org.uk](http://www.refugee-action.org.uk)

Refugee Council, charity number: 1014576 [www.refugeecouncil.org.uk](http://www.refugeecouncil.org.uk)

Scottish Refugee Council, charity number: SC008639 [www.scottishrefugeecouncil.org.uk](http://www.scottishrefugeecouncil.org.uk)

Welsh Refugee Council, charity number: 1102449 [www.welshrefugeecouncil.org](http://www.welshrefugeecouncil.org)